



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:059761
Datë: 13.05.2024
Numri i dokumentit: 05674051

C. nr. 1074/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen juridike kontestimore të paditëses Xh.U. me numër personal të letërnjoftimit nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqësojnë B. K. dhe F.G. që të dy avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 934.8 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 11 maj 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses Xh.U. kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

II. DETYROHET e paditura, që paditëses, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej datës 28.03.2019 deri më datë 07.04.2021 apo për 24 muaj (për çdo muaj shumën prej 38.95 euro, në shkallë prej 19% të pagës bazë- 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 934.8 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë më datë 28.03.2022 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 deri më datë 27.03.2019.

IV. DETYROHET e paditura, që paditëses, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja Xh.U. nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilën me autorizim e përfaqësojnë B.K. dhe F.G. që të dy avokat nga Prizreni, pranë kësaj gjykate më datë 28.03.2022, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose

licencimit, dhe atë nga data 18.04.2017, kur ka hy në fuqi Kontrata Kolektive e Arsimit, e deri në pensionim të paditëses, vlera e kontestit 934.8 euro.

I autorizuari i paditëses në padi, ka theksuar se paditësja ishte në marrëdhënie pune si mësimdhënës pranë SHFMU “Dëshmorët e Kabashit” në Korishë Komuna e Prizrenit, deri në pensionimin e saj. Tutje, ka theksuar duke llogaritur periudhën kohore prej 18.04.2017 e deri në pensionim për 2 vite, paditëses i ka takuar e drejta e kompensimit për 19% të vlerës së pagës bazë, e cila është 421 euro, ku i është paguar vetëm shuma prej 41.04 euro, e na bazë të përgatitjes profesionale SHLP, është dashtë që të paguhet për muaj 79.99 euro, përkatësisht shuma prej 38.95 euro në muaj nuk ju ka paguar. Të njëjtës për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e deri në pensionim janë bërë 24 muaj të cilat shumëzohen me shumën prej 38.95 euro del shuma e përgjithshme prej 934.8 euro. Andaj, ka propozuar që të aprovohet e bazuar kërkesëpadija e paditësit, të detyrohet e paditura t’ia kompensojë shumën e përgjithshme prej 934.8 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave të pa paguara nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, me kamatë ligjore prej 8%. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar lidhur me kompensimin nga marrëdhënia e punës, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditëses se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësja nuk ka paraqitur fakte se është anëtare e kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësja ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. E paditura ka kontestuar kërkesëpadinë duke u bazuar në nenin 90 par. 1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate, ndërsa në këtë rast padia për vitin 2017 dhe deri më 23.04.2021, sipas LMD-së neni 353, kjo e drejtë është parashkruar. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadija e paditëses të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e paditura, në kuptim të nenit 398 dhe 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadija e paditëses është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja Xh.U. ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë SHFMU “Dëshmoret e Kabashit” në Kaorish të Prizrenit. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditëses a i takon e drejta e kompensimit

të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit si dhe nëse kërkesa e paditëses për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkruar.

Në këtë drejtim, gjykata përmes kontratës së punës nr. 43/2017/3 e datës 14.09.2017, e lidhur ndërmjet paditëses dhe të paditurës, gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune pranë të paditurës. Po ashtu përmes vërtetimit me numër 1062/21 e datës 02.04.2021, vërtetohet se Xh.U. këtu si paditës ka qenë në marrëdhënie pune në SHFMU "Dëshmorët e Kabashit" në Korishë të Prizrenit, të njëjtës i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të pensionimit, gjegjësisht arritjen e moshës 65 vjeçare më datë 07.04.2021. Kualifikimi i paditëses ka qenë Shkolla e Lartë Pedagogjike "Xhevde Doda" në Prizren, fakt i cili vërtetohet edhe nga Diploma me numër 383, e datës 05.07.1978 e lëshuar nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, në emër të paditëses, për gjuhë dhe të letërsisë shqiptare. Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditëses është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditëses në emër të kualifikimit, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 41.04 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se "shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të". Andaj, meqë këto dokumente, përkatësisht kontrata e punës, Vërtetimi dhe lista e pagave janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që "nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit". Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se "mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%". Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që "për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008", vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t'ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, paditëses ia ka paguar shumën prej 41.04 euro. Sipas pikës 4 nën pikën 4 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësja përfiton ngritje prej

19% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësja përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumë prej 79.99 euro.

Mirëpo, duke marrë parasysh që kërkesa e paditëses është parashtruar lidhur me pagën bazë në lartësi prej 421.00 euro, gjykata vendosi që paditëses i takon pjesa e diferencës së papaguar lidhur me pagën bazë në shumë prej 421.00 euro apo në shumë prej 38.95 euro. Në këtë drejtim, gjykata vendosi si në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësit për periudhën kohore prej datës 28.03.2019 deri më datë 07.04.2021, si datë e daljes në pension të paditëses shumë e përgjithshme prej 934.8 euro. Pra, diferenca e papaguar në shumë prej 38.95 euro, duke e shumëzuar për 24 muaj ($24 \times 38.95 = 934.8$ euro).

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumë përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 28.03.2022, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në anën tjetër, sa i përket pjesës refuzuese, gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësi padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 28.03.2022, ndërsa kërkesa e saj ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar sipas nenit 87 të LP-së për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit iu ka parashkruar pjesa e kërkesës nga data 18.04.2017 deri më datë 27.03.2019. Gjithashtu sa i përket periudhës kohore për të cilën është kërkuar kompensimi dhe atë nga data 18.04.2017, e deri në pensionimin të paditëses, sipas llogarisë së gjykatës bëjnë 43 muaj e 21 ditë, mirë po gjykata vendosi që ti njihen 24 muaj sipas pretendimit-kërkesës të palës paditëse, të cilat kur shumëzohen shuma e përgjithshme del 934.8 euro, pasi që kërkesa e paditëses ka qenë kjo shumë, Andaj, bazuar në nenin 2 par. 2.1 të LPK-së, parashihet që në procedurën kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse, pra mbi këtë bazë gjykata vendosi brenda kërkesës së palës paditëse, më gjerësisht si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Më saktësisht, gjykata vlerëson se përkundër faktit se paditësit e drejta për kompensimin e pagës shtesë mbi bazën e kualifikimit i është bërë e arritshme në fund të muajit- fillim të muajit, sipas nenit 87 të Ligjit të Punës, në mënyrë specifike dhe konkrete përcaktohet se kërkesat e tilla ndërpriten me rastin e parashtrimit të kërkesës- padisë, sipas nenit 369 të LMD-së. Kështu, paditësja ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së saj në procedurë gjyqësore nga data 28.03.2019 deri më datë 07.04.2021, si datë e daljes në pension. Andaj, mbi këtë bazë gjykata aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses sikurse në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të aktgjykimit, ndërsa pjesën tjetër e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën III. të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep

aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”. Po ashtu, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe në kuptim të nenit 399 par. 1 të LPK-së, pasi që pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit është e pabazuar në dispozita ligjore. Në këtë drejtim, sipas nenit 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditësit t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 124.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 20.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 398 e 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.1074/2022, datë 11 maj 2024

B. Profesional,
Ilir Sërtollaj

Gjyqtari,
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.